DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-831/8
-01-
Data Datum Date 31.07.2019

**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*

*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*

*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit<br>Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Adrijana Hodžiić, Ministre e MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Xhevat Tafa, U.D i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL | Datë: 23/07 /2019<br>Nr. 020-831 |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit | |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim | |

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 15NR. 463-48445 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit |
| I miratuar më datë: 18.07.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 22.07.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural ***<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>***.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-831/8
-VI- Data Datum Date 31.07.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Imri Ahmeti, gradonačelnik opštine Lipjane<br>Daut Azemi, predsedavajući Skupštine opštine | |
| Kopija: | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini | |
| Preko: | Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a | |
| Od: | Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS | Dana: 23.07.2019.<br>Br.020-831 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Lipjane | |
| Vrsta akta: | Odluka | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka 15br.463-48445 za odobrenje izabrane ponude od strane komisije za procenu davanja na korišćenje nepokretne imovine opštine Lipjane. |
| Usvojena dana: 18.07.2019. godine |
| Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 22.07.2019. godine |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta ***u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi*** i kao takav može proizvoditi pravni efekat.
Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 22.07.2019
| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
| --- | --- | --- | --- |
| -01- 020-83 | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 18. 07. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë

# VENDIM
## PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET, oferta e përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1. "Gërlica Company sh.p.k"-Magjistralja Babush i Ri. rr."Xhevë Lladrovci"-Ferizaj, është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës.
2. Pronat e paluaitshme të Komunës, gjinden në Zonën kadastrale Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve, si në vijim:

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Kultura-klasa | Sipërfaqe m² |
| --- | --- | --- | --- | --- | --- |
| 1 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01049-4 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 13370 |
| 2 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |
| 3 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01977-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 7063 |
| 4 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01984-2 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16730 |
| 5 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409059-00562-4 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 53120 |
| 6 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409059-00562-6 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 49296 |

3. Shfrytëzimi i pronave do të jetë 16 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Në pronat e cekura do të ushtrohet veprimtaria: shfrytëzimi i shkëmbinjëve-seperim të gurëve, apo të ngjajshme sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 2

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës – sektori pronesor- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

**15Nr. 463 - 48/45**
**Lipjan, më 19. 07. 2019**

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Badr Azemi**

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 22.07.2019
-VI- 220-831

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovi člana 12. Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040.Službene Novine Republike Kosova . Br 28 dt 04 Juni 2008. člana 19 stav 3 Zakona za Davanje na korišcenje I zamenjivanje nepokretne Opštinske imovine Br.06/I -092. Službene Novine Republike Kosova . Br 10 dt 3 April 2019 članova 20 Statuta Opštine Lipljan 1Br.110-623 dt 26 .09. 2008. Skupština Opštine Lipljan na sednici održanoj dana 18.07.2019. nakon razmatranje predloga Predsdnika Opštine usvoila:

## ODLUKA
## ZA USVAJANJE IZABRANE PONUDE OD KOMISIJE ZA PROCENIVANJE ZA DAVANJE NA KORIŠĆENJE NEPOKRETNE IMOVINE OPŠTINE LIPLJAN

### Član 1

USVAJA SE . izabrana ponuda komisije za procenivanje za davanje na dugoročno korišćenje Opštinske imovine:

1. "Gërlica Company sh.p.k"-Magistrala Babush i Ri. rr."Xhevë Lladrovci"-Uroševac. je korisnik nepokretne imovine Opštine.
2. Nepokretne imovine Opštine nalazi se u katastrsku zonu Donje Gadime i Babush i Muhadera.:

| Br | Vlasnik | Katasarska Parcela | Katastarska zona | Kultura-Klasa | Površina m² |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Državna Svojina S.O. Lipljan | P-71409028-01049-4 | Donje Gadimlje | Poljoprivredno-pašnjak kl.6-e | 13376 |
| 2 | Državna Svojina S.O. Lipljan | P-71409028-01049-13 | Donje Gadimlje | Poljoprivredno-pašnjak kl.6-e | 23500 |
| 3 | Državna Svojina S.O. Lipljan | P-71409028-01977-5 | Donje Gadimlje | Poljoprivredno-pašnjak kl.6-e | 7063 |
| 4 | Državna Svojina S.O. Lipljan | P-71409028-01984-2 | Donje Gadimlje | Poljoprivredno-pašnjak kl.6-e | 16730 |
| 5 | Državna Svojina S.O. Lipljan | P-71409059-00562-4 | Babuš Muhadera | Poljoprivredno-pašnjak kl.5-e | 53120 |
| 6 | Državna Svojina S.O. Lipljan | P-71409059-00562-6 | Babuš Muhadera | Poljoprivredno-pašnjak kl.5-e | 49296 |

3. Korišćenje imovine biće 16 godine od dana stupanja na snazi ove odluke .
4. U navedene imovine obavlja će se delatnost: korišćenje kamena separacija kamena ili slične prema standartima određenih sa dispozicijama zakona.

### Član 2

Nakon završavanje roka ugovora imovna se vraća vlasniku imovine-Opštini.

### Član 3

Prava i obaveze stranaka će se uredivati sa posebnom ugovorum sklopljen između Predsednika Opštine i korisnika nepokretne imovine Opštine

Član 4

Za sprovođenje ove Odluke stara se Kancelarija Predsednika Pravno imovinski Sktor , Direktorat za Geodeziju i Ktastar.Direktorat za Ekonomiju i Razvoj.

Član5

Ova Odluka stupa na snazi 7 dana nakon objavljivanja u Web sajtu Opštine .

15Br. 016-148445
Lipljan,19.07.2019

SKUPŠTINA OPŠTINE LIPLJAN

PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE
DAUT AZEMI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008.
Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës________2019 të miratojë këtë :

PROPOZIM

# VENDIM
## PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

### Neni 1

MIRATOHET, oferta e përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1. "Gërlica Company sh.p.k"-Magjistralja Babush i Ri, rr."Xhevë Lladrovci"-Ferizaj, është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës.
2. Pronat e paluajtshme të Komunës, gjinden në Zonën kadastrale Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve, si në vijim:

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Kultura-klasa | Sipërfaqe $m^2$ |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01049-4 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 13370 |
| 2 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |
| 3 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01977-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 7063 |
| 4 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01984-2 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16730 |
| 5 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409059-00562-4 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 53120 |
| 6 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409059-00562-6 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 49296 |

3. Shfrytëzimi i pronave do të jetë 16 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Në pronat e cekura do të ushtrohet veprimtaria: shfrytëzimi i shkëmbinjëve-seperim të gurëve, apo të ngjajshme sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

### Neni 2
Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

### Neni 3
Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës – sektori pronesor- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12. 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 , nenit 20 dhe 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

Në pajtim me neni 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr-463-14811 të datës 04.03.2019, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit ka shpallë njoftim publik, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347 me datë 07.05.2019.

Hapja publike e ofertave është bërë me datë 24.05.2019 në ora $10^{00}$ në sallën e Kuvendit Komunal, dhe Komisioni ka përzgjedhur "Gërlica Company sh.p.k"-Magjistralja Babush i Ri, rr. "Xhevë Lladrovci"-Ferizaj, si shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës në afat prej 16 viteve për pronat e paluajtshme të Komunës, parcelat kadastrale të cekura në nenin 1 pika 2 e këtij propozim-Vendimi.

Lidhur me ofertën e përzgjedhur, në pajtim me dispozitat e Ligjit është respektuar afati për parashtrimit e ankesave dhe, lidhur me këtë nuk ka arritur asnjë ankesë kundër ofertës së përzgjedhur nga Komisioni.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 463-45307
Lipjan, Më 08.07.2019

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 19 par 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraprake të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-14811 të datës 04.03.2019, Njoftimit Publik 1Nr-463-30347 të datës 07.05.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës pas përfundimit të procedurës së vlerësimit njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në kohëzgjatje prej gjashtëmbëdhjetë (16) vitesh të pronës së paluajtshme të Komunës të mbajtur me datë 24.05.2019, shpallë:

## NJOFTIM
## PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE

I. Të përzgjedhurit nga njoftimi publik 1Nr-463-30347 të datës 07.05.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës janë:

1. "Gërlica Company sh.p.k" Magjistralja Babush i Ri Rr.Xhev Lladrovci-Ferizaj është e rekomanduar si përfituese për ngastrat kadastrale si në vijim të tabelës;

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Kultura-klasa | Sipërfaqja m2 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01049-4 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 13370 |
| 2 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |
| 3 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01977-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 7063 |
| 4 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409028-01984-2 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16730 |
| 5 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409059-00562-4 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 53120 |
| 6 | Pasuri shtetërore K. K. Lipjan | P-71409059-00562-6 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 49296 |

II. Palët e pakënaqura nga procesi i vlerësimet të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të njoftimit ka të drejtë të parashtrojnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditë kalendarike pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave.

III. Pas përfundimit të afatit për parashtrimin e ankesave, Kuvendi Komunal miraton ofertat e përzgjedhura nga Komisioni Vlerësues.

1-463-38769
Datë:11.06.2019

Shkelzen Hajdini, Kryesues i Komisionit

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E LIPJANIT**
**OPSHTINA LIPLJAN**
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

| | |
|---|---|
| **DATË/A** | 05.07.2019 |
| **REFERENC-Ë :** | 15-463-45266 |
| **PËR/ZA/TO:** | Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal në Lipjan |
| **CC:** | Anëtarët e komisionit vlerësues për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit |
| **NGA/OD/FROM:** | Shkelzen Hajdini, Kryesues i komisionit vlerësues për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Raport i komisionit vlerësues për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës mbi vlerësimin e ofertave të pranuara bazuar në Njoftimin Publik Nr.1-463-30347 |

Të nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin Bazuar në Ligin Nr. 06/l-092 për Dhënje në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimin Paraprak për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës 15NR.463-14811, me datë 04.03.2019, Komisioni vlerësues për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit ofron raportin me ofertat e vlerësuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në Njoftimin Publik për Dhënje në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347, me datë 07.05.2019.

Komisioni vlerësues ka zbatuar procedurat për dhënje në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit duke u bazuar në Ligin Nr. 06/l-092 për Dhënje në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës. Komisioni vlerësues ka mbajtur takimin për inicimin e procedurave për shpalljen e njoftimit publik Nr.1-463-31069 më 24.04.2019 në ora 14:00. Njoftimin për Dhënje në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347 është nxjerrë më 07.05.2019 dhe është bërë publik në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

Njoftim Publik ka përmbajtur të dhënat si vijon: të dhënat kadastrale të pronave, lokacionin, përshkrimin, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, kriteret, kushtet dhe kufizimet, formën e konkurrimit, arsyeshmërinë, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, procedurat, kohën dhe vendin e mbajtjes së ankandit publik.

Pronat e shpallura në njoftim publik kanë qenë:

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Kultura -klasa | Sipërfaqja m² |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-9 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 22040 |
| 2 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-10 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16395 |
| 3 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-11 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 36732 |
| 4 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-4 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 13370 |
| 5 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-12 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 30000 |
| 6 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |
| 7 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01977-4 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 5899 |
| 8 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01977-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 7063 |
| 9 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-2 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16730 |
| 10 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-3 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 18335 |
| 11 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 14400 |
| 12 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-6 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 1600 |
| 13 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409059-00559-5 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.4-të | 5875 |
| 14 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409059-00562-4 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 53120 |
| 15 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409059-00562-6 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 49296 |

Më 24.05.2019, në ora 10:00, në Sallën e Kuvendit Komunal, Komisioni vlerësues për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, në përbërje prej gjashtë anëtarëve ka bërë hapjen publike të ofertave. Kryetari i Komisionit ka pyetur Komisionin nëse ndonjëri prej anëtarëve ka konfikt interesi dhe ka pyetur të pranishmit nëse ofertat janë të mbyllura ashtu siç i kanë dorëzuar kur kanë aplikuar. Mbasi që anëtarët e komisionit janë deklaruar se nuk kanë konflikt interesi komisioni ka proceduar me hapjen e ofertave.
Komisioni ka pranuar dhe ka hapur në prani të aplikuesëve këto oferta:

1. Xhani SHPK - Hamit Alija

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Kultura -klasa | Sipërfaqja m² |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-9 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 22040 |
| 2 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-10 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16395 |
| 3 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-11 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 36732 |

2. NPP Niti SHPK

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-12 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 30000 |
| 6 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |
| 11 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 14400 |

3. Zhuti SHPK – Arben Hashani

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |

4. NPTP Hashani

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |
| 10 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-3 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 18335 |

5. Gërlica Company

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-4 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 13370 |
| 6 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 23500 |
| 8 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01977-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 7063 |
| 9 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-2 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16730 |
| 14 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409059-00562-4 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 53120 |
| 15 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409059-00562-6 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 49296 |

Mbas hapjes së ofertave, Komisioni ka informuar aplikuesit se Komisioni do të vlerësoj ofertat, do të publikoj njoftimin për përzgjedhjen e ofertave dhe do të informoj palet e përfshira në proces. Me tutje, komisioni informoj aplikuesit se mbas përfundimit të afatit për shqyrtim të ankesave do të procedoj ofertat e perzgjedhura për aprovim në Kuvend Komunal.

Më 29.05.2019, 30.05.2019 dhe 31.05.2019 Komisioni vlerësues është takuar dhe ka vlerësuar ofertat një nga një duke i krahasuar me kriteret e përcaktuara në Njoftimin Publik për Dhënje në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347.

Komisioni vlerësues rekomandon përzgjedhjen e Gërlica Company si përfituese në Njoftimin Publik për Dhënje në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347 për pronat:

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-4 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 13370 |
| 6 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01049-13 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 23500 |
| 8 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01977-5 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 7063 |
| 9 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409028-01984-2 | Gadime e Ulët | Bujqësore-kullosë kl.6-të | 16730 |
| 14 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409059-00562-4 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 53120 |
| 15 | Pasuri shtetërore/K. K. Lipjan | P-71409059-00562-6 | Babush i Muhaxherëve | Bujqësore-kullosë kl.5-të | 49296 |

Arsyetim:

Gërlica Company ka prezentuar licencën valide të shfrytëzimit e cila është vërtetuar në listën e kompanive të licencuara për shfrytëzim të pranuar nga Komisioni i Përhershëm për Miniera dhe Minerale, të cilin zyrtarisht dhe me shkrim e ka kërkuar Zyra Ligjore.
Kjo kompani ka dorëzuar dokumentacion mjaftë të kompletuar dhe i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në Njoftimin Publik për Dhënje në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347.
Vlera e deklaruar investive për rregullimin e pozitës për shfytëzim, seperacionit, dhe minim nga kjo kompani është 527,608.47€; ndërsa, plani i parashikuar i investimeve teknike nga kjo kompani për vitet 2019-2023 është 796,000.00€. Numri i parashikuar i të punësuarëve nga investimi në Gadime do të rritet nga 15 në 20 punëtorë.
Gërlica Company ka paraqitur projektin tekniko investiv dhe projektin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Kjo kompani ka prezentuar deklaratat për rrespektimin e shenjave në rrugët lokale për peshën e transportuesëve, ruajtjen e ambientit dhe është deklaruar se do të asfaltoj dhe mirëmbajë rrugën deri në punishte së bashku me kompanitë të cilat operojnë në atë pjesë.

Komisioni nuk rekomandon përzgjedhjen e aplikueseve të tjerë të cilët kanë aplikuar ngase nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar dhe nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin Publik për Dhënje në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347.

Arsyetim:

SHPK ZHUTI – Arben Hashani ka ofruar një licencë me afat të skaduar në vitin 2016. Në listën e kompanive të licencuara për shfrytëzim të ofruar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk figuron si kompani e licencuar. Kjo ndërmarrje ka paraqitur një projekt tekniko investiv. Kjo kompani është zotuar për rrespektimin e shenjave në rrugët lokale për peshën e transportuesëve, ruajtjen e ambientit dhe është deklaruar se do të asfaltoj dhe mirëmbajë rrugën deri në punishte së bashku me kompanitë të cilat operojnë në atë pjesë. Kjo kompani ka paraparë të punësoj 10 punëtorë.

NPTP Hashani ka ofruar në aplikacion nga një kopje të lejes për aktivitete të veqanta dhe lejes për shfrytëzim/minig licencë; mirëpo, kjo kompani nuk figuron si kompani e licencuar për shfrytëzim në listën e ofruar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Kjo ndërmarrje ka paraqitur projektin tekniko investiv ku ka paraqitur edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Kjo kompani ka prezentuar deklaratat për rrespektimin e shenjave në rrugët lokale për peshën e transportuesëve, ruajtjen e ambientit dhe është deklaruar se do të asfaltoj dhe mirëmbajë rrugën deri në punishte së bashku me kompanitë të cilat operojnë në atë pjesë.

NPTP Hashani ka dekalaruar se tani ka 14 punëtorë. Në periudhën 1 deri në 2 vite do të punësoj 7 punëtorë ndërsa në periudhën 2-5 vite do të punësoj 40 punëtorë. Vlera investive afatmesme dhe afatgjate e parashikuar është 1,036,000.00€.

Xhani SHPK – Hamit Alija nuk ka ofruar një plan tekniko investiv, kështu që nuk ka prezentuar vlerën të cilën do ta investoj në rast të përzgjedhjes. Poashtu kjo kompani ka cekur se tani kanë 18 punëtorë, mirëpo nuk ka cekur se sa punëtorë do të punësoj gjatë periudhës 16 vjeqare.

Bazuar në konfirmimin zyrtar të pranuar Komisioni për Miniera dhe Minerale, të cilin zyrtarisht dhe me shkrim e ka kërkuar Zyra Ligjore, figuron se kjo kompani ka licencë valide për shfytëzim. Për kriteret tjera kjo kompani nuk ka prezentuar deklaratat për rrespektimin e shenjave në rrugët lokale për peshën e transportuesve, ruajtjen e ambientit dhe nuk është deklaruar se do të asfaltoj dhe mirëmbajë rrugën deri në punishte.

NP P. NITI SH.P.K ka prezantuar projektin tekniko investiv në të cilin deklaron se tani ka 15 të punësuar dhe në të ardhmen do t'i punësoj edhe 12 punëtorë. Në këtë projekt NP.P. NITI SH.P.K ka cekur vlerën të cilën ka investuar deri kur i ka skaduar kontrata. Mirëpo, komisioni nuk ka mundur të gjejë në dokumentacion vlerën e investimit për periudhën 16 vjeqare nëse përzgjedhet si përfitues. Kompania ka prezentuar licencën valide për shfytëzim dhe bazuar në konfirmimin zyrtar të pranuar, Komisioni për Miniera dhe Minerale figuron se kjo kompani ka licencë valide për shfrytëzim.

Kjo kompani poashtu nuk ka prezentuar dokumentacion me të cilin zotohet për dy kritere: Rruga deri në punishte të asfaltohet dhe të mirëmbahet me qëllim të ruajtjes së ambientit dhe Pesha e automjeteve transportuese-kamionëve në rrugët lokale duhet të jetë sipas kufizimeve të përcaktuar.

Ky raport përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik ka të bashkangjitur këto dokumente:

1. Njoftimin Publik për Dhënje në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.1-463-30347, me datë 07.05.2019.
2. Vendimin Paraprak për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës 15NR.463-14811, me datë 04.03.2019,
3. Procesverbalet e takimeve të mbajtur të komisionit vlerësues me 29.05.2019, 30.05.2019 dhe 31.05.2019
4. Procesverbalin e ankandit publik të mbajtur me 24.05.2019.

.............................................................................................................................................

Me respekt,

020 - 241/12
29.03.2019

# Republika Kosovo - Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit<br>Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini , U.D e Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL | Datë: 12/03 /2019<br>Nr. 020-241 |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës se Lipjanit | |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim | |

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

